



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Në bazë të Nenit 3 pika 7 dhe të Nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (LSHCRK), përkatësisht të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall:

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës: **Psikolog/e** (një pozitë)

Referenca: IAPK – 4/2014

Paga-koeficienti: 15

Mbikqyrësi: Drejtori i Departamentit të Hetimeve

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të pacaktuar, periudha provuese 12 muaj

Vendi: Prishtinë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofron shërbime dhe mbështetje psikologjike në trajtimin e rasteve të pranura që janë me ngarkesa të theksuara emocionale,
- Të menaxhojë të gjitha rastet specifike në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në bashkëpunim me juristët/këshilltarët ligjorë,
- Të bëjë vizita edhe jashtë institucionit lidhur me trajtimin e rasteve me çrregullime psikologjike, me qëllim të dhënies së opinionit dhe vlerësimit profesional,
- Kordinohet dhe bashkëpunon me drejtorin e departamentit të hetimeve dhe juristët/këshilltarët ligjorë lidhur me rastet që kanë nevojë për ofrimin dhe trajtimin psikologjik të rasteve brenda dhe jashtë IAP-së,
- Ruan fshehtësinë e përmbajtjes së bisedave në seancat këshilluese për rastet e trajtuara,
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin, përgjegjës për shërbime profesionale edhe për stafin e IAP-së,
- Përgatit raporte si dhe paraqet rastet për IAP ose për palët e treta, në konsultim dhe në bashkëpunim edhe me shërbimet e jashtme profesionale psikiatrike,
- Pranon, interviston, këshillon apo udhëzon palët në zyre dhe në terren,
- Ndërmjetëson me autoritetet publike apo organizatat dhe institucionet tjera,
- Kryen detyra të tjera që ndërlidhen me natyrën e punës dhe në rrethana specifike sipas nevojës, të cilat caktohen nga mbikqyrësi

Përgatitja profesionale, kualifikimi, aftësitë dhe karakteristikat tjera:

- Diplomë universitare në psikologji – e obligueshme;
- Përvojë e punës profesionale së paku dy (2) vjet - e obligueshme;
- Njohje e gjuhës shqipe ose serbe në të folur dhe të shkruar - e obligueshme;
- Njohja e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar - preferohet;
- Të ketë aftësi të mira menaxhuese dhe komunikuese;
- Aftësi të punoj i pavarur, nën presion, i motivuar dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike, me qëndrime dhe opinione të ndryshme;
- Aftësi në përdorimin e kompjuterit në programet e MS Office dhe internet – e obligueshme
- Aftësi të punojë i/e pavarur dhe të mbajë standarde të larta profesionale;
- Të respektojë parimet e humanitetit, konfidencialitetit dhe profesionalizmit,
- Vërtetimin nga gjykata se nuk është nën hetime apo i dënuar për veprë penale (jo më i vjetër se 6 muaj) – i obligueshëm.

Procedura e konkurimit

Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i përmbushin kriteret e konkursit.

Formularët për punësim mund të merren në zyrën e IAP, apo në ueb faqen e internetit: www.ombudspersonkosovo.org.

Formularët për punësim mund të dorëzohen personalisht në zyrën qendrore të Institucionit të Avokatit të Popullit në Prishtinë, Rr. „Enver Maloku“, nr. 28, Bregu i diellit, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale (letërnjoftimi dhe ekstrakti i lindjes) dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura si dhe vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale.

Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Institucioni i Avokatit të Popullit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës pa asnjë dallim.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në rast të numrit të madh të aplikacioneve, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor. Data e fundit për aplikim është 23.10. 2014.

Kërkesat e dërguara pas kalimit të afatit për aplikim, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në nurmin e telefonit 038 223 782 apo në email adresën zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar por, nuk janë zgjedhur, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe të ankimimit, gjegjësisht 90 ditë nga momemti i skadimit të afatit të aplikimit. Dokumentet që nuk tërhiqen asgjësohen.